



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM

Nr. 99, datë 10.03.2022

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Eglantina Mikani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Objekti: “Kërkesë për pushimin e procedimit penal nr.397 viti 2020 për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 283/a/1 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Herila Çela dhe Mirela Mishgjoni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehurit{...}, etj.; Akuza: “Nenet 283/2 e 25 dhe 278/6 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Arbana Selmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Kërkesë për kalimin në gjykim të procedimit penal nr.14/2 viti 2021 dhe kërkesë për pushimin e procedimit penal nr.14/2 të vitit 2021”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Kultivim i bimëve narkotike”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 278/3 dhe 236/2 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR